

VENDIM
Nr. 6, datë 30.1.2014

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË HEC “ULËZ”-“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE “BISTRICA 2” NË KUADËR TË MARRËVESHJES ME “IFC”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 8 të “Rregullores së procedurave e të transferimit të aseteve të të licencuarve”, si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e datës 30.1.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se janë plotësuar sipas kërkesave ligjore, pikat si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2

Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit.

- Neni 7, pika 1.3/“a”, “b”

Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij.

- Neni 7, pika 1.3/“c”

Gjendja financiare në kohën kur paraqitet kërkesa dhe efekti i pritshëm pas transferimit të aseteve.

Janë plotësuar, gjithashtu, pika 1.3/“d”, “e”, “f”, “g”, “h” të nenit 7 të rregullores:

- Pika 1.3/“d” - Përshkrimin e kandidatit përfitues.

- Pika 1.3/“e” - Arsytet dhe shkakut ligjor i barrësimit - motivet.

- Pika 1.3/“f” - Efektet e pritshme të transferimit (dhënies peng/hipotekë) në aktivitetin e të licencuarit.

- Pika 1.3/“g” - Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar.

- Pika 1.3/“h” - Marrëveshja paraprake.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., për transferimin e aseteve të HEC “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2” në kuadër të marrëveshjes me “IFC”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti